

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Murator Sektori KUB

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

Muratori varet nga Përgjegjësi i sektorit dhe ka keto detyra:

1. Zbaton detyrat dhe urdhrat e punës të dhëna nga Përgjegjësi i sektorit dhe kryen procesin e punës të caktuar prej tij.
2. Zbaton brenda kriterëve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga Përgjegjësi dhe raporton për realizimin e tyre.
3. Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.
4. Zbaton në çdo kohë, sipas udhëzimeve të eprorëve rregullat dhe masat e sigurimit teknik në punë.
5. Njofton Përgjegjësin, për çdo problem që mund t’i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tij.
6. Është në gatishmëri edhe pas kohës së punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence

Të njoftojë eprorin, për çdo problem që mund t’i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe të ndjekë udhëzimet që i jepen nga eprori për vazhdimin e detyrës

Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 5 dite.

Kandidadet do te vleresohen ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do te shpalle fituesit ne portalin “ Sherbimi Kombetar I Punesimit”, ne faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.

